



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 2026/0620

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, neni 108/A paragrafi 7 dhe neni 109 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të kërkesës së datës 25.08.2026 për tërheqje nga ankesa e parashtruar nga OE "Euro Abi" Sh.p.k. e datës 20.08.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja verore dhe dimrore e rrugëve në territorin e komunës së Vitisë -tre vjeçar" me numër të prokurimit; 657-26-5446-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Vitisë, Paneli Shqyrtues në përbërje nga Isa Hasani – kryetar, Kimete Gashi dhe Vedat Poterqoi-anëtar, me datën 08.09.2026, mori këtë:

VENDIM

1. Aprovohet, kërkesa e datës 25.08.2026, e parashtruar nga OE "Euro Abi" Sh.p.k për tërheqjen e ankesës me nr. 2026/0620 e datës 20.08.2026 të parashtruar për aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja verore dhe dimrore e rrugëve në territorin e komunës së Vitisë -tre vjeçar" me numër të prokurimit 657-26-5446-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Vitisë.
2. I lejohet, autoritetit kontraktues – Komuna e Vitisë që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën një (1) të vendimit, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.
3. I kthehet tarifa e sigurimit ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës nr.2026/0620, pasi e ka tërhequr ankesën para pranimit të akt ekspertizës në sistem e-prokurimi, neni 28.1 të Rregullores së Punës së OSHP-së. Obligohet OE ankues që konform neni 31 pika 6 të rregullores së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesën për tërheqjen e tarifës të sigurimit të ankesës, në të kundërtën konfiskohet tarifa dhe mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Euro Abi" Sh.p.k me datën 20.08.2026, ka parashtruar ankesë në OSHP, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja verore dhe dimrore e rrugëve në territorin e komunës së Vitisë -tre vjeçar" me numër të prokurimit; 657-26-5446-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Vitisë.

Operatori ekonomik "Euro Abi" Sh.p.k me datën 25.08.2026 përmes sistemit e-prokurimi, ka shkruar se e tërheqë ankesën lidhur me aktivitetin e sipërcituar të prokurimit.

Zyrtari përgjegjës i Organit Shqyrtimit Publik, me datën 26.08.2026 përmes emailit, ka konstatuar se në sistem e-prokurimi nuk ka pas të dorëzuar ndonjë akt ekspertizë të ekspertit shqyrtues për këtë ankese dhe se operatori ekonomik ankues e ka të paguar tarifën për sigurimin e ankesës.

Me rastin e informimit lidhur me veprimet e përshkruara si më sipër, Paneli Shqyrtues mori vendim për aprovimin e kërkesës për tërheqje nga ankesat e OE-ve ankues duke i lejuar AK që ta vazhdojë aktivitetin e prokurimit (i përshkruar si më sipër) nëse AK nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet. Krahas kësaj po ashtu duhet theksuar se efekti pezullues i ankesës në kuptim të nenit 112, paragrafi 1, të LPP sipas të cilit dorëzimi i një ankese e obligon AK që automatikisht ta pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit në rastin konkret duhet të largohet. Bazuar në faktet dhe rrethanat e përshkruara shkurtimisht si më sipër, konstatohet se janë krijuar kushtet (prezumimet ligjore) që të përfundoj procedura ankimore në këtë fazë, pa nevojë që të hapet faza e vlerësimit meritohet nga paneli shqyrtues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, sepse mungon objekti ankimor (ankesa është tërhequr) dhe elementet qenësore të ankesës sipas nenit 111 të LPP;

Bazuar në faktet dhe rrethanat e përshkruara shkurtimisht si më sipër, konstatohet se janë krijuar kushtet (prezumimet ligjore) që të përfundoj procedura ankimore para OSHP në këtë fazë dhe lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, për faktin se:

- a) mungon objekti ankimor dhe elementet qenësore të ankesës sipas nenit 111 të LPP;
- b) ankuesit, i mungon statusi i palës së interesuar, sipas nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP.

Në këtë rast duhet theksuar se në kuptim të nenit 13, të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative (LPPA), secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik. Kurse në kuptim të nenit 109, paragrafi 1, të LPP, po ashtu parashihet se çdo palë e interesuar ka të drejtë të parashtojë ankesë pranë OSHP. Mirëpo, në kuptim të parimeve bazë të legjislacionit, posaçërisht parashikuar me dispozitën e nenit 93 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, kjo njëherësh kjo nënkupton faktin se çdo palë e interesuar ka të drejtë po ashtu ta ndryshoj (plotësoj, përmirësoj, precizoj) ankesën dhe po ashtu ta tërheqë atë. Në fakt, Paneli Shqyrtues ka konfirmuar faktin e tërheqjes së ankesës, bazuar në veprimet e palës përmes publikimit të tyre në platformë

përkatësisht faqen zyrtare të sistemit të prokurimit publik, prandaj nuk gjeti arsye për të vepruar në kuptim të nenit 110 të LPP andaj janë krijuar kushtet që procedura në këtë çështje juridiko administrative të përfundoj në kuptim të nenit 97 të LPPA.

Megjithatë, Paneli Shqyrtues i vë në dijeni AK, në çdo aktivitet duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP-së.

Bazuar në faktin se operatori ekonomik ka tërhequr ankesën nr.2026/0620, para pranimi të raportit të ekspertizës së ekspertit shqyrtues, të njëjtit konform nenit 28 paragrafi 1 të Rregullorës së Punës së OSHP, i kthehet tarifa sigurimit për parashtrim të ankesës.

Citat neni 28 par 1 i Rregullorës: *“Pala mund ta tërheqë ankesën në çdo kohë. Në rast se ankesa tërhiqet para shqyrtimit të ankesës dhe/ose emërimit të ekspertit shqyrtues dhe para pranimi të akt-ekspertizës, do të bëhet kthimi i tarifës së ankesës”.*

Prandaj bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t’i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithëshem për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t’i dorëzohet:

1x1 AK

1x1 OE ankues

1x1 Arhivës së OSHP-së;

Isa Hasani
Kryetar i Panelit Shqyrtues

